

#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit

Kështjellë

Mosha

Periudha zhvillimore (nga 3 deri në 8 vjet)

Vendi / lokacioni

Kushte shtëpie

Vlera e karakterit

Saktësi

Koha e nevojshme për përgatitje

10 minuta

Koha e nevojshme për realizim

20-25 minuta

Qëllimet

Qëllimi është që tek fëmija të zhvillohet koordinimi ndërmjet syrit dhe dorës, saktësi dhe aftësi ta përdor dorën dominante.

Rezultate të pritshme

Kahje

Përgatitje paraprake për aktivitet

Përgatitje të materialeve për lojë (gota plastike ose cilindra). Nëse luhet me cilindra kartoni (pjesa e brendshme e letrës së tualetit), mund paraprakisht në to të vizatohen forma me ngjyra (p.sh. për cilindrata e rradhës së parë të kenë rradhë të kuq, në rradhën e dytë katrorë të gjelbër e të ngjashme).

Nëse luhet me gota plastike mund të shkruhen numra nga 1 deri në 5 (nëse janë fëmijë shkollorë mund të shkruhen numra nga 1 deri në 15), me marker (rradha e parë, gjegjësisht pesë gotat të jenë me numrin 5, pastaj 4 gota me numrin 4 etj., deri në majë dhe një gotë me numrin 1).



Instrukcione / kahje për lojën

Në këtë lojë nevojitet që gotat të vendosen si kështjellë në 5 kate, gjegjësisht në bazament (në tavolinë) vendosen 5 gota njëra pranë tjetrës, mbi to vendosen 4 gota (e para vendoset në mes ndërmjet gotës së parë dhe të dytë – për të patur stabilitet), pastaj rradhiten 3 në rradhën e tretë, 2 në rradhën e katërt dhe një gotë në majë.

Aktivitet / lojë

Fëmijës i shpjegohet mënyra e vendosjes së gotave / cilindrave. Gotat e secilit pjesëmarrës janë para vetes, të kthyer me fundin lart, e janë të përziera që të mundohet t'i gjejë sipas formës ose numrit. Ai anëtar i familjes, i cili i pari do ta rregullojë kështjellën me gota / cilindra ka për detyrë të trillojë / të tregojë një rrëfenjë për trimin e kështjellës ose ndonjë ndodhi nga kështjella ose ndonjë ndodhi për kështjellën që është bërë, sipas përzgjedhjes së pjesëmarrësit.

Kjo lojë mund të përsëritet sipas interesit të pjesëmarrësve ose të jetë garuese nëse luajnë më shumë anëtarë të familjes – kush i pari do e bëjë kështjellën.

Shtojca

Materiale

15 gota plastike ose cilindra kartoni për një pjesëmarrës; ngjyra; marker

Aktiviteti është përgatitur nga edukatorët:

Krijuar nga: Sonja Çallovaska, Vesna Peceva

Dizajni grafik: Katerina Nikolovska

